Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 531/01
Datë 14.12.2015

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014 të datës 20. 11. 2014 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4, 7, 10, 11, 16 dhe 17, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 14.12.2015 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për akreditimin dhe validimin e Institucionit "Cacttus Education Sh.P.K" në Prishtinë për periudhën 14.12.2015 deri 14.12.2018 për të ofruar:

1.1 Zhvilllues i UEB-it dhe aplikacioneve mobile, niveli V sipas KKK.

Akreditimi dhe validimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Në hyrje të objektit nuk ka pjerrinë për lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara (personave me karrocë). Rekomandohet që në hyrje të objektit të ndërtohet pjerrina e cila do të ua lehtësonte qasjen në ndërtesë personave të këtyre kategorive.
- Katër sallat e mësimit janë në katin e parë dhe të dytë dhe kjo nuk mundëson qasje edhe për studentët eventual të cilat janë me nevoja të veçanta (personat me karrocë). Rekomandohet që të bëhet zgjidhje duke mundësuar që në katin përdhese të dedikohet një sallë e mësimi për personat me aftësi të kufizuara.
- Sallat e trajnimit (4 sosh) janë të pajisur me 12+1, 14 +1 dhe 16+1 kompjuterë. Nëse grupi i studentëve do të jetë më i madh se kapacitetit i sallave, atëherë rekomandohet që salla të jetë më e madhe dhe e pajisur me më shumë kompjuterë, ose numri i studentëve për grup të jetë më i vogël.

- Përkundër që janë përgatitur syllabuset për secilën lëndë/modul, mungon orientimi dhe paketat mësimore. Rekomandohet që për secilën lëndë/modul të përcaktohet literatura bazë dhe ajo përcjellëse.
- Nëse kandidati nuk e kalon testin final, atëherë nuk dihet cila është procedura për mundësinë e ri testimit. Rekomandohet që të ketë procedurë të shkruar për mënyrën e ri testimit të kandidatëve.
- Meqenëse një pjesë e mësimdhënësve të propozuar janë për herë të parë në procesin edukativ, rekomandohet që të kenë trajnime për procesin e vlerësimit.
- Me qëllim të sigurimit të cilësisë, rekomandohet që të caktohet komisioni ose se paku një person nga stafi i rregullt në pozitën e koordinatorit të sigurimit të cilësisë.
- Përveç klasave të mësimit dhe një kuzhine tepër të vogël, nuk ka hapësirë tjetër ku studentët do të mund ta kalonin kohën e lirë. Rekomandohet që të ketë hapësira të tjera për qëndrim jashtë kohës së mësimit.
- Në kontratat e studentëve dhe mësimdhënësve duhet të figurojnë obligimet tri paleshe kontraktuale mbi "Pronësinë Intelektuale" me rastin e zhvillimeve të aplikacioneve gjatë studimeve e të cilat mund të komercializohen dhe të jenë fitimprurëse.
- Sinjalizimet në objekt dhe brenda klasave mësimore mungojnë. Rekomandohet të shenjat orientuese të vendoset në të gjitha katet dhe në të gjitha hapësirat e ndara duke i sinjalizuar qartë me emërtimet përkatëse për secilën hapësirë.
- Rekomandohet që të zhvillohet procedura për njohjen dhe transferin e kredive të arritura nga kandidatët në dhe nga institucione të tjera.
- Rekomandohet të që zhvillohet procedura për vlerësimin e kandidatëve me nevoja të veçanta.
- Rekomandohet që të zhvillohet procedura për ngritjen dhe zhvillimin e stafit e sidomos të stafit mësimdhënës i cili do të garantonte sigurimin e cilësisë.
- Rekomandohet që mostrat e testimit të studentëve të dorëzohen në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve.
- (Afati kohor i këtyre kushteve: 01.09.2016)

1.2 Administrator i sistemit dhe rrjetit kompjuterik, niveli V sipas KKK.

Akreditimi dhe validimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Të ofrohet dëshmi për marrëveshjen me qiradhënësin e objektit.
- Të ofrohet dëshmi për partneritet me vendorët si: Android, CompTIA, Cisco, Microsoft, Oracle, PearsonVUE dhe LPI.
- Të ofrohen ekzemplarë të paketave mësimore (literaturës mësimore).
- Të ofrohen ekzemplarë të testeve të rregullta dhe të projekteve finale.

- Riorganizimi i sallave mësimore në mënyrë që të jenë nga 20 kompjuter në salla.
- Të definohet koha e arkivimit të provimeve, testeve dhe ushtrimeve.
- Të emërohet koordinatori për njohjen së mësimit paraprak dhe të trajnohet stafi.
- Të mundësohet qasja në katet e objektit për personat me karroca.
- Riorganizimi i sinjalizimit në hapësirën e brendshme.
- Pjesëmarrësit të nënshkruhen në listën e vijueshmërisë.
- Të organizohet puna praktike.
- Mbrojtja e të dhënave personale.
- Vendosja e kutisë së ankesave/falënderimeve

(Afati kohor i këtyre kushteve: 01.09.2016)

1. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

- Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit;
- Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
- Raporti i Vetë-vlerësimit;
- Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1 Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi i dërgohet:

- Institucionit "Cacttus Education Sh.P.K" ;
- AKK.

Nën- Kryetari i KD së AKK-së
Anton Gojani